



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva


## KUVENDI I KOMUNËS

Duke u mbështetur në nenet 11, 12.2 dhe 17 shkronja s), neneve 14, 15 paragrafi 2.4 dhe 19 paragrafi 1.19 të Statutit të komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 07 prill 2023, pas shqyrtimit dhe diskutimeve rreth Kërkesës Qendres Gjenocidi në Kosovë – Plagë e Hapur, unanimisht mbështeti këtë;

## DEKLARATË

Kuvendi i Komunës së Podujevës përkrahë dhe mbështetë idenë, respektivisht Kërkesën e Qendrës Gjenocidi në Kosovë – Plagë e Hapur, që Lulëkuqja me katër (4) petale të jetë simbol i viktimave në Kosovë dhe kështu Lulëkuqja me katër (4) petale të bëhet simbol unik i përkujtimit të gjenocidit në Kosovë.

Kuvendi i Komunës së Podujevës pohon se katër (4) petalet e Lulëkuqes në logon e dizajnuar paraqesin qartë katër format e akteve gjenocidiale që Serbia zbatoi në Kosovë, të cilat janë: vrasjen, dhunën seksuale, spastrimin etnik dhe shkatërrimin e objekteve që lidhen me përkatësinë etnike dhe identitetin Shqiptar.



*Lulëkuqja sipas kësaj deklarate*

*Nr. Prot. 01-016/01-0025741/23*  
**Podujevë, 07 prill 2023**



**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Filmi Hoxha**